UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

DEPARTAMENTI "PEDAGOGJI- PSIKOLOGJI"

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: **Edukimi dhe Psikologjia**

Tema: "Roli i mësuesit te shëndeti mendor i maturantëve, gjatë mësimit online"

Punoi: Sidorela Laska

Programi i studimit :Master i Shkencave në degen Mësuesi në Shkencat Sociale AML

Tiranë, 2021

Hyrja

I. Qëllimi dhe metodologjia e punimit

Fillimi i pandemisë së koronavirusit në mars 2020 mbylli çdo shkollë në vend dhe detyroi distriktet të riorganizojnë operacionet e tyre për të ofruar udhëzime në distancë në një bazë emergjence. (MALKUS, N. 2020).

Një sfidë për të gjithë sistemin arsimor, për mësuesit e nxënësit, ku të parët duhet të përpiqen fort për të kryer misionin e tyre, në kushte të vështira dhe me lëkundje të sigurisë së tyre profesionale apo me pikëpyetje pa përgjigje duke qenë të detyruar të mbyllin një vit akademik nëpër ekrane. Nga ana tjetër e monitorit janë fëmijët e adoleshentët, të cilëve gjithashtu nën ndikimin e mësimit virtual, iu shtohet stresi. Ndjenja që më së shumti përjetojnë studentët, mësuesit e nxënësit, përgjatë kësaj periudhe, ka të bëjë me paqartësi të shumta, lodhje, humbje të besimit, mund të ndihen të "tradhtuar" nga sistemi, pa referenca, pa mbështetje dhe të stresuar. (Lorela Garuli, 2020).

Në këtë punim, ne do të analizojmë rolin e mësuesit në shëndetin mendor te maturantët gjatë mësimit online. Rëndësinë që ka ky rol dhe efektet që sjell në shëndetin mendor. Fusha e studimit është pedagogjike dhe psikologjike. Për të realizuar këtë studim, kemi aplikuar tri fazat dhe metodologji si në vijim:

Faza e parë: *Zgjedhja e literaturës*. Qëllimi i përzgjedhjes së literaturës lidhet me përcaktimin saktë të fushës së studimit, gjenerimi i pyetjeve kërkimore, evidentimi i asaj çka është arritur dhe çka mbetet për t'u arritur nëpërmjet thellimit të njohjes. Zgjedhja e literaturës është shtrirë mbi një numër të konsiderueshëm autorësh të ndryshëm, të huaj dhe shqiptarë.

Faza e dytë: *Mbledhja e të dhënave*. Kjo fazë përfshin grumbullimin e të dhënave nga intervistat me maturantët, mësuesit, psikologun shkollor. Mandej metoda e dytë që është përdorur për këtë fazë lidhet me vëzhgimin.

Faza e tretë: *Analiza e të dhënave*. Në realizimin me sukses të objektivave të caktuara në këtë studim jemi mbështetur në metodën e analizës dhe sintezës, ku të dhënat e grumbulluara janë

strukturuar sipas kërkesës së studimit dhe pastaj janë përpunuar për të arritur deri te konkluzionet e punimit.

II. Struktura dhe rëndësia e punimit

Punimi ndahet në dy boshte kryesore. Boshti i parë është teorik, në cilin përfshihet shqyrtimi i literaturës. Në kapitullin e parë kemi trajtuar si temë, "Mësimin online gjatë pandemisë së Covid-19". Në kapitullin e dytë kemi trajtuar çështjen e shëndetin mendor të maturantëve gjatë kësaj periudhe. Ndërsa në kapitullin e tretë kemi trajtuar "Rolin e mësuesit në shëndetin mendor të maturantëve gjatë Covid-19".

Përzgjedhja dhe trajtimi i një studimi shkencor mbi një fushë kërkimore të caktuar, ka rëndësinë e saj akademike dhe shkencore, duke shfrytëzuar të gjitha elementet teorike, hulumtuese dhe metodologjike.

Rëndësia e këtij punimi shihet në këto elemente kryesore:

- Trajtojmë një fushë studimore të rëndësishme në mësimdhënie. Tema është koherente, lidhet me periudhën që po jetojmë me pandeminë Covid-19. Studime të tilla të ngjashme në kontekstin shqiptar, mungojnë.
- Analizojmë rolin e mësuesit te shëndeti mendor i maturantëve gjatë mësimit online.
- Nëpërmjet analizës cilësore të marrë nga intervistat e realizuara dhe vëzhgimi me maturantët, mësuesit dhe psikologun shkollor, arritëm në një konkluzion më të qartë se cili është roli i mësuesit në shëndetin mendor të maturantëve gjatë mësimit online.

Kapitulli I

Vështrim bibliografik mbi mësimin online në arsimin e mesëm gjatë Covid -19

1.1 Mësimi online në Shqipëri

Në rastin e Shqipërisë, mësimdhënia në distancë përbën një risi të plotë, edhe për faktin se kuadri i brendshëm legjislativ nuk parashikon forma të tillë të mësimdhënies, ndryshe nga shumë vende të tjera, ku edukimi në distancë është një alternativë e mundshme për nxënësit dhe studentët. Në Shqipëri nuk është e mundur ligjërisht të ndjekësh një studim online, apo të frekuentosh arsimin parauniversitar në distancë, përveç disa rasteve sporadike që lidhen me edukimin e fëmijëve nga familje të ngujuara. Arsimi në distancë nuk ka pasur një bazë ligjore, kjo zbrazëti ligjore ka penalizuar edhe shumë qytetarë që kanë ndjekur programet e ngjashme në universitetet e huaja duke mos u njohur diplomat dhe duke i ekuivalentuar kreditet e marra. Kuadri ligjor përbën njërën prej problematikave që duhet të adresohet në të ardhmen. (Erlis Çela,2020)

Efekti i pandemisë mbi arsimin me siguri është i ndryshëm në vende të ndryshme të globit, dhe kjo varet nga një sërë faktorësh që dallojnë vendet nga njëra-tjetra, të tilla si zhvillimi ekonomik, përparimi i teknologjisë dhe elementeve të tjera që ndërlidhen me to. Në Shqipëri, problematikat që janë hasur në mësimin online janë disa, për sa kohë për ne mësimi online është një risi.

Kapitulli II

Vështrim bibliografik mbi rolin e mësuesit në shëndetin mendor të maturantëve gjatë mësimit online në periudhën e pandemisë

2.1 Roli i mësuesit në shëndetin mendor të maturantëve

Everett, 2015 shqyrtoi disa studime në lidhje me angazhimin e studentëve në mjediset e të mësuarit në internet dhe theksoi rëndësinë e mësuesve që krijojnë ndërveprime të qëllimshme për të lehtësuar të mësuarit. (Robinson edhe Hullinger 2008) sugjeruan që instruktorët duhet të përfshijnë mundësitë që studentët të mësojnë nga njëri-tjetri për të krijuar një ndjenjë të komunitetit në klasë, e cila potencialisht mund të rrisë angazhimin e studentëve. (Robinson edhe Hullinger 2008).

Studentët ndonjëherë janë proaktivë dhe të përfshirë në aktivitetet e të mësuarit në klasë, por ndonjëherë janë vetëm reagues dhe pasivë. Sipas kuadrit dialektik brenda teorisë së vetëvendosjes, studentët zotërojnë burime të brendshme motivuese që kushtet e klasës mund t'i mbështesin ose t'i frustrojnë. Kur mësuesit gjejnë mënyra për të ushqyer këto burime të brendshme, ata adoptojnë një stil motivues që mbështet autonominë. Mësuesit mund të mësojnë se si të jenë më mbështetës për autonominë ndaj nxënësve; mësuesit më së shumti angazhojnë studentët kur ata ofrojnë nivele të larta të mbështetjes dhe strukturës së autonomisë; dhe një stil motivues që mbështet autonominë është një element i rëndësishëm për një marrëdhënie mësues-nxënës me cilësi të lartë. (Reeve, J. 2006).

Një studim interesant u bë në shkollat e mesme në Zelandën e Re për mësimin online. Ky studim raporton përvojën e studentëve në të mësuarit digjital në shtëpi gjatë Covid-19. Kjo kornizë ofron tri karakteristika që ndikojnë në përvojën e nxënësve kur përdorin pajisje digjitale për të mësuar: personalitetin, vërtetësinë dhe bashkëpunimin.
(Anne Pates, Luise Starkey, Ben Egerton, Florian Flueggen, 2020)

Sipas një studimi të kryer nga Roeser, R. W., dhe Midgley, C. mbi rolin e mësuesit në shëndetin mendor të nxënësve, rezultatet e anketës treguan se shumica e mësuesve (99%) besonin se adresimi i nevojave të shëndetit mendor të nxënësve ishte pjesë e rolit të tyre, por ndiheshin disi të ngarkuar nga këto nevoja, veçanërisht në klasa me nxënës që shfaqnin vështirësi më të mëdha. (Roeser, R. W., & Midgley, C. 1997).

Mësuesit më së shumti angazhojnë studentët kur ata ofrojnë nivele të larta të mbështetjes dhe strukturës së autonomisë; dhe një stil motivues që mbështet autonominë është një element i rëndësishëm për një marrëdhënie mësues-nxënës me cilësi të lartë. (Reeve, J. 2006).

Nëse u kërkohet nxënësve të përshkruajnë një mësues të mirë, përshkrimet e tyre përcaktojnë tre cilësi. Së pari, mësuesit e mirë vendosin marrëdhënie të mirë ndërpersonale, ata kujdesen për nxënësit e tyre. Së dyti, mësuesit e mirë mbajnë rregull në klasë dhe ruajnë autoritetin e tyre pa u treguar të ngurtë. Së treti, mësuesit e mirë, arrijnë të motivojnë nxënësit e tyre. Ata janë të aftë të bëjnë mësimin interesant, duke qenë krijues dhe inovativ dhe duke bërë që nxënësit të marrin diçka nga mësimi. (Woolfolk.A, 2011).

Kapitulli III

Metodologjia

Në këtë studim është përdorur metodologjia hulumtuese me metoda kualitative. Fillimisht u grumbullua informacioni nëpërmjet literaturës së huaj dhe asaj shqiptare, si dhe studimeve të përafërta me temën tonë. Metodat që u përdorën në studim janë të qasjes cilësore, si intervistat dhe vëzhgimi. Fillimisht realizuam vëzhgimin, gjatë mësimit online, nga data 12 mars deri më 2 prill, me maturantët e shkollës së mesme “Hydajet Lezha”, ku aplikacionet me të cilat zhvillohej mësimi online ishin Akademi.al dhe WhatsApp. Intervista u realizua me 40 maturantë, 10 mësues dhe psikologun e shkollës (triangulim burimesh). Intervista nuk është e njëjta për të tria burimet, pra janë tri intervista të ndryshme, të realizuara me google forms. Ky studim që

hulumton rolin e mësuesit në shëndetin mendor të maturantëve u zhvillua në dy faza: 1) Vëzhgimi i kryer gjatë procesit mësimor online; 2) Intervista me maturantët, mësuesit dhe psikologun e shkollës.

Pyetjet kërkimore

1- Cili është roli i mësuesit në shëndetin mendor te maturantët, gjatë mësimit online?
2- Si ndikon mësimi online te psikologjia e maturantëve?
3- Cilat janë efektet psikologjike të shëndetit mendor të maturantëve gjatë mësimit online?
4- Si mund t'i ndihmojnë mësuesit maturantët që të ndihen mirë psikologjikisht, gjatë mësimit online?

Kapitulli IV

Gjetjet e hulumtimi

5.1 Analiza e Vëzhgimit

Lloji i vëzhgimit: Kemi të bëjmë me një vëzhgim sistematik shkencor që bazohet në një strukturë më specifike. Në këtë rast, aspektet specifike që do të vëzhgohen janë përcaktuar tashmë qartë në temën "Roli i mësuesit në shëndetin mendor te maturantët, gjatë mësimit online". Ndikimi i mësimit online te psikologjia e maturantëve, mbështetja e mësuesve te maturantët që të ndihen mirë psikologjikisht.

Vëzhgimi është realizuar me maturantët e gjimnazit "Hydajet Lezha" ku kemi zhvilluar praktikën shkollore. Vëzhgimi nisi më 12 mars dhe zgjati deri më 2 prill. Mësimi online është zhvilluar te platforma Akademi.al dhe aplikacioni WhatsApp me 7 klasat matura të kësaj shkolle, përkatësisht: C, D, G, E, F, H, I. Me metodën e vëzhgimit synojmë të shikojmë nga afër se cili

është roli i mësuesit në shëndetin mendor të maturanteve gjatë mësimit online. Dokumentimi i të dhënave të vëzhgimit është realizuar me shënime.

5.2 Analiza cilësore e Intervistave

5.2.1 Intervista e maturantëve

Nëntë tema të dallueshme dolën nga analiza e intervistës së maturantëve. Temat kryesore të identifikuara:

1. Mendimi i maturantëve rreth mësimit online: Kryesisht e cilësonin si metodë joefektive e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
2. Maturantët të stresuar, të mbingarkuar dhe në ankth gjatë mësimit online.
3. Të stresuar dhe në ankth, maturantët e shikonin mësimin online si një disavantazh për provimet e maturës.
4. Maturantët jo të motivuar kishin ndjesi lodhjeje dhe monotoni gjatë mësimit online.
5. Maturantët shprehën probleme psikosomatike, probleme me shëndetin të shkaktuara nga stresi i mësimit online.
6. Ndryshoi pozitivisht psikologjia e maturantëve kur u rikthyen në shkollë.
7. Mësuesit i kanë ndihmuar nxënësit të përshtateshin në mësimin online duke hapur klasa virtuale dhe duke bërë videoleksione.
8. Mësuesit i kanë ndihmuar nxënësit të ndihen mirë psikologjikisht duke i këshilluar dhe motivuar kryesisht mësuesit e tyre kujdestar.
9. Për gjysmën e maturantëve ishin mësuesit faktor stresues, ndërsa për gjysmën tjetër nuk ishin faktor stresues.

5.2.2 Intervista e mësuesve

Pesë tema të dallueshme dolën nga analiza e intervistës së mësuesve. Temat kryesore të identifikuara:

1. Sipas mësuesve, nxënësit e kishin shumë të vështirë përshtatjen në mësimin online dhe kryesisht kishin qëndrime negative.
2. Mësuesit kanë vërejtur ndryshime në sjelljen e nxënësve dhe kryesisht ndryshime negative.
3. Sipas mësuesve, nxënësit nuk ishin fare të motivuar dhe iu nevojitej të gjejnë metoda që t'i motivojnë.
4. Problemi më i shpeshtë që shprehen mësuesit ishte mungesa e motivimit të nxënësve që i bënte që të mos angazhoheshin në mësim.
5. Sipas mësuesve, psikologjia e maturantëve ishte kryesisht negative duke qenë se ato besonin që mësimi online do të ndikojë negativisht te provimet e maturës.

5.2.3 Intervista e psikologut

Pesë tema të dallueshme dolën nga analiza e intervistës së psikologut shkollor. Temat kryesore të identifikuara:

1) Ndikim negativ i mësimit online në psikologjinë e nxënësve;
2) Mungesa e ndërveprimit fizik me mësuesin dhe shokët e klasës i demotivon dhe iu heq dëshirën për të studiuar gjatë procesit mësimore online;
3) Efektet negative psikologjike të shëndetit mendor të maturantëve gjatë mësimit online;
4) Në shumicën e rasteve maturantët shprehnin shqetësime për mësimin online si mungesë të motivimit, stres, ankth;
5) Mësuesi luan rolin kryesor dhe vendimtar në shëndetin mendor të maturantëve gjatë mësimit online.

Kapitulli V

Diskutimi i gjetjeve

6.1. Krahasimi midis gjetjeve të vëzhgimit dhe të intervistave

6.1.2 Të përbashkëtat e gjetjeve të vëzhgimit dhe intervistave.

Sipas mësuesit, ndryshonte dhe gjendja psikologjike e maturantëve. Këtë rezultat e kemi dhe te vëzhgimi, por edhe nga intervistat kryesisht nga intervistat e maturantëve dhe psikologut shkollor. Një mësues motivues dhe nxënësit ishin më pozitivë dhe kishin dëshirë të përfshiheshin në mësim. Ndërsa një mësues indiferent që e bën mësimin si proces mekanik, nxënësit ndiheshin të pamotivuar dhe niveli i stresit për mësimet rritej me shumë. Ky rezultat gjithashtu ka dalluar nga të dyja metodat, nga vëzhgimi dhe intervistat e maturantëve. Maturantët, mësimin online e konsideronin një disavantazh për ato, që nuk do të marrin rezultatet e dëshiruara në provimet e maturës. Rezultoi që mësimi online ka kryesisht ndikim negativ te psikologjia e maturantëve. Mbështetja e mësuesve te maturantët që të ndihen mirë psikologjikisht është e rëndësishme, sepse mësuesit luajnë një rol kryesor në psikologjinë e nxënësve. Këto gjetje rezultuan tek të dyja metodat si te vëzhgimi dhe tek intervista.

6.1.3 Dallimet e gjetjeve të vëzhgimit dhe intervistave.

Te vëzhgimi, ndryshe nga intervistat rezultoi dhe rëndësia e komunikimit dhe përdorimi i simboleve (emoji) në komunikimin me shkrim me nxënësit, si një metodë efektive në motivimin e nxënësve.

Ndërsa tek intervista e maturantëve rezultoi se maturantët shprehën probleme psikosomatike, probleme me shëndetin të shkaktuara nga stresi i mësimit online. Një gjetje që te vëzhgimi nuk rezultoi.

Efekte negative psikologjike të shëndetit mendor të maturantëve gjatë mësimit online. Kjo rezultoi nga intervistat, ndërsa te vëzhgimi kishte efekte negative dhe pozitive, ndryshe nga intervistat ku shprehen vetëm efekte negative.

Kapitulli VI: Përfundimet, Propozimet

Përfundimet kryesore të studimit

Mësuesi luan rolin kryesor dhe vendimtar në shëndetin mendor të maturantëve gjatë mësimit online. Roli i mësuesve është mjaft i rëndësishëm në mosushtrimin e presionit që lidhet me të mësuarit dhe sigurisht në praktikimin e teknikave herë pas herë të cilat relaksojnë nxënësit dhe rrisin kënaqësinë në të mësuar. Shohim se mësuesit janë pasqyra për nxënësit atë që do reflektojnë te nxënësit ajo do të kthehet pas.

Maturantët, mësimin online e konsideronin një disavantazh për ato, që nuk do të marrin rezultatet e dëshiruara në provimet e maturës. Rezultoi që mësimi online ka kryesisht ndikim negativ te psikologjia e maturantëve. Mësimi online ka demotivuar nxënësit dhe ka shkaktuar një rënie të interesimit të tyre për mësimet. Ndikim negativ mësimi online ka në psikologjinë e nxënësve. Vërejmë që nga përgjigjet me të shpeshta të mësuesve ishte që nxënësit shfaqeshin të frikësuar dhe të pasigurt gjatë mësimit online.

Rezultuan efekte negative psikologjike të shëndetit mendor të maturantëve gjatë mësimit online. Si vetmi, izolim, mbyllje, sheshim emocional, ndjenja depersonalizimi dhe derealizmi, “burn-out”, dhe efektet më të zakonshme psikologjike lidhen më së shumti me shtimin e stresit e të ankthit. Maturantët shprehën probleme psikosomatike, probleme me shëndetin të shkaktuara nga stresi i mësimit online.

Nga vëzhgimi dhe intervistat rezulton se mbështetja e mësuesve te maturantët që të ndihen mirë psikologjikisht është e rëndësishme, sepse mësuesit luajnë një rol kryesor në psikologjinë e nxënësve. Mësuesja që po vëzhgonim, edhe pse maturantët kishin qëndrim negativ për mësimin online dhe ishin të stresuar, kur zhvillonin mësim me të ishin më pozitivë, sepse mësuesja kishte krijuar një klimë pozitive, përdorte metodat e saj motivuese.

Rëndësia e komunikimit dhe përdorimi i simboleve (emoji) në komunikimin me shkrim me nxënësit një metodë efektive në motivimin e nxënësve.

Mësuesi mund të ndihmojë në shumë mënyra të ndryshme maturantët që të ndihen mirë psikologjikisht, gjatë mësimit online. Kryesorja është t'i kuptojë nxënësit e tij dhe të krijojë një marrëdhënie pozitive me to.

Rekomandimet

1) Duke u mbështetur nga intervistat që maturantët shprehën se mësimi online nuk është efektiv dhe që iu shkakton stres duke qenë se të njëjtën gjë shprehen dhe mësuesit në intervistën e tyre. Unë do të rekomandoja që mësuesit dhe nxënësit të vendosin së bashku se si do të realizohet mësimi online në çfarë platforme, me çfarë metodash që të jetë sa më e përshtatshme për të dyja palët dhe efektive.

2) Duke u referuar te maturantët që shprehën probleme psikosomatike, probleme me shëndetin të shkaktuara nga stresi i mësimit online. Nga 40 maturantë të intervistuar, 39 shprehen që kishin shqetësime për shkak të stresit si çrregullime të ushqyerit, probleme me gjumin, dhimbje stomaku, dhe një nxënës që u diagnostikuar nga mjeku me sëmundje psikosomatike, stresi i mësimeve i shkaktoi probleme me stomakun, stresi i provimeve të maturës ishte shumë i lartë.
   Ne rekomandojmë qe t'ju kushtohet një rëndësi më e madhe gjendjes psikologjike të maturantëve. Gjatë mësimit online janë fokusuar me shumë te rezultatet e të nxënit dhe vlerësimeve të provimeve të maturës, duke anashkaluar gjendjen e tyre emocionale, që mund të shkaktojë shqetësime serioze.

3) Duke u mbështetur te pyetja, si mund t'i ndihmojnë mësuesit maturantët që të ndihen mirë psikologjikisht, gjatë mësimit online? Ne rekomandojmë që mësuesi duhet të komunikojë me nxënësit e tij dhe së bashku të gjejnë mënyrat e duhura duke krijuar një marrëdhënie pozitive me nxënësit që do e kenë më të lehtë t'iu gjejnë zgjidhje vështirësive që mund të dalin gjatë procesit mësimor.

Bibliografia

Anne Pates, Luise Starkey, Ben Egerton, Florian Flueggen , n.d. High school student eksperienc of online learning during covid-19 the influence of technology and pedagogy. *Taylor and Francis..*

Bergeler, E. &. R. M. F., 2020. Comparing Learning Outcomes and Satisfaction of an Online Algebra-Based Physics Course with a Face-to-Face Course.. *Journal of Science Education and Technology*, pp. 1-15.

Brannen, S., Ahmed, H., & Newton, H. (2020). *Covid-19 Reshapes the Future*. Center for Strategic and International Studies (CSIS). http://www.jstor.org/stable/resrep25198

Bell, B. S., & Federman, J. E. (2013). E-Learning in Postsecondary Education. *The Future of Children*, *23*(1), 165–185. http://www.jstor.org/stable/23409493

Burnam, M. A., Berry, S. H., Cerully, J. L., & Eberhart, N. K. (Eds.). (2014). Student Mental Health. In *Evaluation of the California Mental Health Services Authority's Prevention and Early Intervention Initiatives: Progress and Preliminary Findings* (pp. 87–138). RAND Corporation. http://www.jstor.org/stable/10.7249/j.ctt14bs358.13

Çela, E., 2020. Edukimi online ne eren e Covid-19. *Portali Shkollor Albas.*

Zhu, C. (2008). E-learning, Constructivism, and Knowledge Building. *Educational Technology*, *48*(6), 29–31. http://www.jstor.org/stable/44429624

Dans, E., n.d. *Why 2020 will be Online Educations Biggest Year..* [Online] Available at: Retrieved from: https://www.forbes.com/sites/enriquedans/2020/05/19/why-2020- will-be-online-educations-biggestyear/#4a0e7f7a7eca

Darby, F., 2019. How to Be a Better Teacher Online Advice Guide.. *Retrieved from: https://www.chronicle.com/interactives/advice-online-teaching.*

Guce, L., 2017. Edukimi në distancë. *Luljeta Guce*, JAN.

Hayeon Song ,Jihyun Kim , Wen Luo., n.d. Teacher-student relationship in online classes A role of teacher self-disclosure. *Science Direct* .

Hunt, A. N. (2020). Access to Mental Health Care during and after COVID-19. In G. W. Muschert, K.
M. Budd, M. Christian, D. C. Lane, & J. A. Smith (Eds.), *Social Problems in the Age of COVID-19*

Vol 1: Volume 1: US Perspectives (1st ed., pp. 113–121). Bristol University Press. https://doi.org/10.2307/j.ctv15d81tx.16

Heather Clark. (2017). “Imbalance:”: Mental Health in Higher Education. *Humboldt Journal of Social Relations*, *39*, 346–348. http://www.jstor.org/stable/90007891

MALKUS, N. (2020). *Reopening in the Shadow of COVID-19: BEGINNING THE FIRST FULL CORONAVIRUS SCHOOL YEAR*. American Enterprise Institute. http://www.jstor.org/stable/resrep26789

World Health Organization. (2020). *Consideraciones psicosociales y de salud mental durante el brote de COVID-19*. World Health Organization. http://www.jstor.org/stable/resrep28097

Oranization, W. H., 2014. *Mental health: strengthening our response".*, s.l.: World Health Organization.

Oranization, W. H., 2021. *World Health Oranization.* [Online] Available at: https://www.who.int/teams/mental-health-and-substance-use/covid-19

Romas, E., 2020. Pandemic virtual learning impacts teen mental health. *MIDDLETON Wis WMTV* .

Reeve, J. (2006). Teachers as Facilitators: What Autonomy-Supportive Teachers Do and Why Their Students Benefit. *The Elementary School Journal*, *106*(3), 225–236. https://doi.org/10.1086/501484

Roeser, R. W., & Midgley, C. (1997). Teachers’ Views of Issues Involving Students’ Mental Health. *The Elementary School Journal*, *98*(2), 115–133. http://www.jstor.org/stable/1002138

Shah, A. A., & Beinecke, R. H. (2009). Global Mental Health Needs, Services, Barriers, and Challenges. *International Journal of Mental Health*, *38*(1), 14–29. http://www.jstor.org/stable/41345271

WHO, 2001. *"The world health report 2001 – Mental Health: New Understanding, New Hope",* s.l.: s.n.

Woolfolk.A, 2011 . *Psikologji Edukimi.* Tiranë : CDE.